

RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Arritja e barazisë gjinore si dhe minimizimi i dhunës ndaj grave e vajzave si dhe dhunës në marrëdhëniet familjare përbëjnë një prioritet të rëndësishëm, të lidhura ngushtë me proceset integruese të vendit.

Përpjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, synojnë përmirësimin e mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar, të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet:

- a) Reduktimi i rasteve të dhunës në marëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtja e veçantë e pa diskriminim e çdo grupei që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje;
- b) Përmbushja e rekomandimeve për Shqipërinë të Komitetit GREVIO, të publikuara në muajin dhjetor 2017, në cilësinë e organit që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit);

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Mbrojtja nga dhuna në familje është sanksionuar në disa konventa dhe instrumente ndërkontaktore të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Në këtë aspekt mund të përmendim: Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 104/2012, datë 08.11.2012, Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e ratifikuar më 11 maj 1994; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Konventën e OKB për të Drejtat Civile dhe Politike, Axitenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Ratifikimi i këtyre instrumenteve ndërkontaktore detyrimet e vendosura për shtetet anëtare sjellin nevojën për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm për parandalimin e dhunës në familje me standartet ndërkontaktore si dhe me rekomandimet përkatëse të organizmave monitoruese të zbatimit të tyre.

Me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2012 dhe me pas në vitin 2013 u parashikua për herë të parë kriminalizimi i veprës penale të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Dënimet variojnë nga dy deri në pesë vjet. Konkretisht, rrahja dhe çdo vepër tjetër dhune dënohet me burgim gjer në dy vjet; plagosja me dashje që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet; kryerja e këtyre veprave në mënyrë të përsëritur osë në prani të fëmijëve dënohet nga një deri në 5 vjet.

Në nenin 50 të K.Penal ku përcaktohen rrethana të caktuara për rëndimin e dënimit parashikohen si të tilla edhe rastet kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen si dhe kur kryerja e veprës penale ndodh gjatë ose pas dhënies së urdhërave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje.

Zbatimi i këtyre sanksioneve nuk ka zbutur dhunën ndaj gruas, madje në disa raste ka patur efekt të kundërt (dhunuesit kanë ri-ushtruar dhunë ndaj viktimitës dhe shumë nga këto raste kanë përfunduar në mënyrë fatale duke marrë jetë vajzash e grash).

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, ka një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje nga 1.998 raste në vitin 2010 deri në 4.951 raste në vitin 2018. Gjatë tre viteve të fundit (2016- 2018), ka pasur një rritje

të vazhdueshme me 9% çdo vit të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje.

Episodet e përsëritura të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, veçanërisht rastet kur dhuna përsëritet edhe ndaj grave që kanë përfituar urdhër mbrojtje nga gjykata, deri në humbjen e jetës, janë këmbanë alarmi për ndërhyrje të menjëherëshme në legjislacion me mekanizma që forcojnë masat kundër dhunës.

Mosreferimi i këtyre rasteve apo ulja e numrit të referimeve në organin e prokurorisë (tendenca e organeve të policisë për ta zgjidhur çështjen me urdhër mbrojtje, pra me masa administrative civile, apo tërheqja e viktimës), hetimi dhe gjykimi i dhunesve në gjendje të lirë, dhe jo me masa të sigurimit personal (arrest me burg) ka ndikuar në përsëritjen e dhunës deri në vrasjen e viktimate të dhunës.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektligi është në përputhje me nenet 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Bazuar në parashikimet e nenit 81 pika 1 të Kushtetutës, projektligi propozohet si nismë deputeti.

Projektligi hartohej në përputhje me qëllimin strategjik 3, “Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Objektivi 3.3.1 “Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje” të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligi nuk përafron e nuk lidhet me asnjë *acquis* të Bashkimit Evropian. Pavarësisht kësaj projektligji synon realizimin e disa prej objektivave të zhvillimit të qëndrushëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht objektivi nr. 5/SDG 5, “*Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave*” dhe objektivit 16: “*Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për*

të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në Raportin **GREVIO**-s mbi zbatimin e Konventës së Stambollit në Shqipëri, i bërë publik në Dhjetor 2017 argumentohet se Neni 33 i Konventës së Stambollit, kërkon që palët të kriminalizojnë dhunën psikologjike, e cila përshkruhet si sjellje me dashje për të dëmtuar rëndë integritetin psikologjik të një personi me anë të shtrëngimit ose kërcënimeve. Në këtë drejtim, abuzimi psikologjik konsiderohet si një formë mbizotëruese e dhunës në familje, e cila mund të perceptohet nga viktimat si më e rëndë dhe më e dëmshme se dhuna fizike. Dhuna psikologjike, sipas përkufizimit të nenit 33 të Konventës, nuk gjen shprehje në Kodin Penal. Në këtë aspekt Raporti i GREVIO-s rekomandon që autoritet kombëtare të korrigojnë mangësitë në legjislacionin penal që lidhen me dhunën psikologjike.

Nga ana tjetër dispozita përkatëse e Kodit Penale që parashikon veprën penale të dhunës në familje ka nevojë të përmirësohet edhe për sa i takon zgjerimit të rrethit të subjekteve që mbrohen prej tij, duke parashikuar edhe personat në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, të gjëzojnë mbrojtjen e nevojshme, kjo në harmoni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimeve ligjore që iu bënë ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Në kuptim të ligjit të sipërcituar “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

Kjo ka rëndësi sepse në shumë raste ku ish partneri ose partneri aktual, që nuk është në lidhje familjare apo bashkëjetese, ka ushtruar dhunë ndaj gruas, ka përfituar nga drejtësia pasi nuk ka patur cilësimin si subjekt i posaçëm i veprës penale.

Dispozita e propozuar parashikon njëkohësisht një ashpërsim të dënimive penale për disa figura të kësaj vepre penale ku:

- a) Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, seksuale, psiko emocionale, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, propozohet të dënohet **me burgim nga një**

deri në pesë vjet, në ndryshim nga parashikimi aktual që përcakton dënim deri në dy vjet burgim.

- b) Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, parashikohet të dënohet me burgim **nga dy deri në pesë vjet**, në ndryshim nga dispozita aktuale që parashikon dënim deri në tre vjet burgim.
- c) Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, parashikohet të dënohet me burgim **një deri në 10 vjet burgim**, dyfishi i masës së dënimit në krahasim me parashikimin e Kodit Penal aktual.
- d) Kryerja në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, e veprave të mësipërme parashikohet të dënohet **nga dy deri në 10 vjet burgim**, dyfishi i masës së dënimit në krahasim me parashikimin e Kodit Penal aktual.

VI. HARTIMI I PROJEKT-AKTIT

Ky projekligj është hartuar me kontributin e deputeteve nismëtare, në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, nën kujdesin e ministres.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE


Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT PROPOZUES

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)



EGLANTINA GJERMENI



7